

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Profesor Shuteriqi personalitet i talentuar, një univers i pashtershëm në disa fusha akademike, shkrimtar me kulturë të gjerë kombëtare dhe europiane..." / Kujtimet e "Lasgushit të Bregut"
ADRESA	https://www.balkanweb.com/profesor-shuteriqi-nje-personalitet-i-talentuar-univers-te-pashtershem-ne-disa-fusha-akademike-shkrimtar-me-kulture-te-gjere-kombetare-dhe-europiane-kujtimet-e-l/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:54:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	5 shtator 2026, 05:10:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 5 shtator 2026, 05:09:00 UTC → 5 shtator 2026, 05:11:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të g abojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bc5e50dfaab65605941fde852688e843407886e8c568fe86d93419a3e28ce090
TEKSTI	ba2cf9b52a064f9cb92c5fb8cb7be8047d60d9ef3496ce0dbf754b584f116662
PAMJA	b379a38d152196696ad479e7036490192044377b5e1d2fa3f0761a486d2bfefd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	582c635fb9a381a3210a8d515eae44277300b0606d32e9084f6ae076cae3697e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/582c635fb9a381a3210a8d515eae44277300b0606d32e9084f6ae076cae3697e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FILLIMI

SHQIPËRIA

KOSOVA

RAJONI

SPORT

BOTA

KULTURË

METROPOL

ANALIZA

TEKNOLOGJI

Fillimi > Dossier

“Profesor Shuteriqi personalitet i talentuar, një univers i pashtershëm në disa fusha akademike, shkrimtar me kulturë të gjerë kombëtare dhe europiane...”/ Kujtimet e “Lasgushit të Bregut”

05 Shtator, 2026 07:10



Madhësia e tekstit:



Nga Lefter Çipa

Profesor Dhimitër Shuteriqin e kisha njohur pa u takuar për së afërmi, nëpërmjet shkrimeve dhe studimeve të tij. Punime që i kryente dhe botonte herë pas here nëpër botime dhe organe, sidomos tek gazeta javore “Drita”, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Më tërhiqnin artikujt e botuar për folklorin shqiptar në veçanti, folklorin e Jugut, të Toskërisë dhe të Labërisë së madhe, ku mençuria dhe dituria e tij më dritësonte shpirtin tim të etur dhe të pasionuar për folklorin e vendeve të mia, sidomos për këngën dhe vallen labo himariote. Është vështirë që të gjykohej dikush i panjohur dhe i pa takuar ndonjëherë, madje pa pasur rastin për t’i shtrënguar dorën e përshëndetjes. Mirëpo në shpirtin tim, Dhimitër Shuteriqi kishte bërë follenë e admirimit. Me të vërtetësish ëndërroja të takohesha dhe të miqësohesha...!

Bëhej fjalë për një personalitet të veçantë, të cilin unë e imagjinoja si një njeri të jashtëzakonshëm, me virtytet, bukurinë, zgjuarsinë dhe shtat-skalitjen ku spikaste urtësia, matura dhe durimi. Dëgjoja shpesh prej intelektualëve që e njihnin, se ishte i ditur dhe i paarrtshëm. Në tërësi, nisa të lexoja veprat e tij të botuara, që nga studimet filologjike,



Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT



Nuk ndalet aksioni qytetar! Protestuesit bllokojnë Rrugën e Elbasanit me kazanë mbeturinash. Shoqërohet “djali i pankartës”

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit nisin sërish marshimin drejt Kuvendit, ecin mes makinave

17 Shtator, 2026



Protestuesit “shkulin” gardhin metalik të Ministrisë së Brendshme, tentojnë të “çajnë” kordonin e policisë. Mërrin “Shqiponjat”

17 Shtator, 2026



FOTO+VIDEO/ Tensionet para Ministrisë së Brendshme, protestuesit hedhin letra higjienike në drejtim të policisë. Një i shoqëruar

17 Shtator, 2026



LIVE- Qytetarët në çdo skaj të qendrës! Protestuesit marshojnë në sheshin Skënderbej, tensione në Bulevard

17 Shtator, 2026

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



kritikat letrare, studimet dhe prurjet me të dhëna për folklorin dhe deri tek studimet historike. Çdo ditë më rritej vlerësimi, dashuria e heshtur, admirimi i plotë dhe i hapur në bisedat që bënim në grupe. Më pëlqente portreti i tij dhe sidomos mënyra e komunikimit dhe e ligjërimit në intervista në revista, gazeta apo televizion dhe radio.

Kur e ndiqja në periudhën e parë të krijimtarisë sime, shpesh thosha e veten: vërtet do ta kem për fat të njihem dhe të bashkëbisedoj e të miqësohem me këtë shkrimtar të vendit tim, i cili çdo ditë më aspironte ndjenjat e një moshe djaloshare në fushën e kulturës. Zëri i punës së Dhimitër Shuteriqit u dëgjua si një zë i lartësisë së mesazheve shpresëdhënëse, të vazhdimësisë dhe pa ndërprerjes në fushën e letërsisë shqipe. Ai inkurajoi gjithë intelektualët dhe krijuesit në arenën kombëtare, sepse shkrimtari Shuteriqi ishte një personalitet i talentuar. Ai mbartte një univers të pashterueshëm në disa fusha akademike. Ishte një shkrimtar i kompletuar me një kulturë të gjerë kombëtare dhe europiane.

Ishte, i pari ndër të parët, që dritësoi në fushën e trashëgimisë folklorike, si një docent i dhembshur për visaret e kombit dhe të popullit të shumëvuajtur. I përcillte të dhënat dhe dashurinë me një dritësim të pa mjegulluar, duke depërtuar në shekuj të errësirës dhe zezimit. Ai shfaqej publikisht me një shpirt plot dritë dijeje, kulture, identiteti dhe pa përgjnjë ndër rrethet e ndryshme dhe në raport me korrentit e shumta. Shuteriqi, si një atdhetar i diturisë dhe zgjuarsisë largpamëse, pati kurajën dhe guximin të reflektonte me kujtimet, studimet dhe krijimtarinë shpesh të paarritshme, dimensionet dhe përmasat vetjake prej personaliteti. Në një ndër ditët e bukura, pas shumë vitesh, pata rastin të takohesha me shkrimtarin e fisme dhe studiuesin sqimatar. Ishte viti 1971.

Në Tiranë zhvillohej Kongresi i VI-të i Partisë së Punës. Si gjithë grupet e tjera artistike të Shqipërisë, Grupi Folklorik i Pilurit ishte caktuar për të marrë pjesë në koncertin jubilar. Ishte nëntori olimpik i festave tradicionale të historisë kombëtare. Natyrisht, në ato vite të furtunave politike, ishte privilegj të zgjidheshe për një koncert të tillë. Kishte kriterë të ndryshme, por spikaste si kryesor prurja artistike. Arritjet artistike të Pilurit i kishin dhënë mundësi të sillte këngën "Komisar i kohëve". Ishte numri më i madh i pjesëtarëve të grupit prej 18 vetash; gjashtë vajza dhe dymbëdhjetë burra. Natyrisht entuziazmi dhe mosha shtonin energjinë dhe shpërfaqnin një temperament artistësh të rinj gjithë impulse. Kjo tërhoqte maksimalisht vëmendjen e artistëve dhe shkrimtarëve të vendit të cilët përgjithësisht merrnin pjesë në ciklin e këtyre veprimtarive të fundvitit.

Mbas shumë ditësh provash të tensionuara, një mbas dite në Pallatin e Kulturës së Tiranës, vjen si i dërguar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve. niktori Petro Kokusha dhe më kërkon personalisht. Pasi u

përsëndetëm, u takuam si patriotë nga një krahinë, (ai nga Vuno dhe unë nga Piluri), shkuam në bufenë e Pallatit për të pirë një kafe. Në bisedë e sipër, Petro më thotë: "I dashur Lefter, nesër në mbas dite, pasi të mbaroni provat, jeni të ftuar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, për një koncert miqësor dhe argëtues në sallën e Lidhjes. Atje do të asistojnë shkrimtarët Dhimitër Shuteriqi, Dritero Agolli, Petro Marko dhe shumë e shumë të tjerë. Do të jetë kënaqësi e madhe edhe për ju si Grup i Pilurit, por edhe për neve si Lidhje, sepse është në prag të Kongresit. Kështu kam besim që dhe ju e keni të kënaqshme një ftesë të tillë që u bëhet nga ana jonë, si një institucion që i përket anës shpirtërore".

Kështu u dakordua për kryerjen e aktivitetit të nesërmen pasdite. Dhe kështu u bë. Të nesërmen pasdite shkuam në Lidhje. Salla ishte mbushur plot e përplot. Sa hymë në një mjedis tjetër, tepër rrëmbyes, entuziast dhe me një gjelbërim shpirtëror. Na u duk vetja se ishim me krahë. Kushdo na përshëndeste me fjalë të zgjedhura. Aty ishte vatra e diturisë kulturore. Kjo mbrëmje e paharruar për ne, koncerti dhe gjithë përgëzimet ishin meritë e Dhimitër Shuteriqit, Dritero Agollit dhe Petro Markos, si patriot nga Bregu. Por ishte edhe mbështetje e shumë të tjerëve, sidomos kompozitorëve Çesk Zadeja, Pjetër Gacit, Limoz Dizdarit, folkloristëve e studiuesve Benjamin Kruta si dhe zëvendësministrit të Arsim Kulturës, Mantho Balës.

Kjo ndodhte pasi Grupi i Pilurit ishte vlerësuar gjatë provave e në vazhdim, për koncertin e madh që do të jepesh në 7 nëntor, në mbrëmje, në Pallatin e Sportit "Partizani". Me një buzëqeshje të grunjtë, si ai gruri i pjekur dhe i vesuar nga vesimi i Hënës, gjatë natës, të cilit në mëngjes i derdhen rrezatimet e syrit të diellit, e njëjta gjë ndodhi edhe me mua. Profesor Shuteriqi ishte i pari nga krerët e Lidhjes që pyeti: "Kush është Lefteri?" Në këtë moment ndjeva një rrezatim gjaku në trupin tim. Ishte diçka e veçantë. Profesori më rrëmbeu dorën dhe më kishte përfshirë në një përqaftim. Ndërkohë që pasuam përqaftime dhe me artistët dhe shkrimtarët e tjerë të ndodhur në atë mbrëmje në koncertin tonë në Lidhje. Ishte një veprimtari që zgjati disa orë.

Ishte një takim me kureshtjen tonë, por dhe të artistëve. Personalitetet na rrethonin me një kureshti dashamirëse. Pasi u përshëndeta nga të gjithë, profesor Çesk Zadeja më kishte qëndruar më pranë. Ndërkohë që Petro Marko nuk priti dhe ia nisi këngës himarjote "Vajzë e valëve". Të gjithë, si zogjtë e bukur sipër valëve të detit, derdhëm simfoninë e shumë-zërave të Pilurit, por edhe të zërave pasionantë të artistëve të penës. Në mënyrë të papritur, Shuteriqi dhe Agolli, hapën braçet e krahëve të tyre dhe nisën të fluturonin.

Në këtë çast ylberizimi të polifonisë, poeti Xhevahir Spahiu derdhi një

“oooooooo” skraparllishe, ku tavan i salles na u duk se ishte i veshur me një qilim Persian, përsipër supeve tanë. Në mbarim të kësaj simfonie shpirtërore, regjisori, “Artisti i Popullit”, me atë zërin e tij dramatik, thërrmonte shkëmbinjtë e stërralltë. Derdhi diksionin e dridhshëm duke thënë: “Kjo është një mrekulli shekspiriane! Këtë duhet ta montojnë në skenën e koncertit që do të japin nesër”.

Një shtëllungim ere bregase u diktua në sallë, ku secili zinte vendin e tij e ku do vijonte aktiviteti. Profesor Shuteriqi më hodhi rishtas krahun së bashku me Dritëroin dhe u vendosa mes tyre. Ata të dy si kontër Parisi, kurse unë si një dre gërxihi, i rrahur nga breshëri dhe era e sertësuar nëpër shtrëngatat e viseve të mia. Koncerti i Grupit të Pilurit nisi me këngën e parë, “Komisari i kohëve”. Kënga u dëgjua me kureshtje të madhe. Për Grupin kjo ishte një provë tepër gjeneralë. Ky koncert në Lidhje ishte dalje para përfaqësuesve më të shquar të vlerave akademike, artistike. Për herë të parë ne kishim kaq shumë personalitete të ditura para, të cilëve po u shpalosnim repertorin tonë si grup. Ne sapo ishim shfaqur në skenën kombëtare me prurjen dhe vlerën e një dukurie të padëgjuar në stil dhe në fjalë.

Kishim nisur të bënim diferencën tonë me stilet fosforike të krahinave të jugut të Shqipërisë. Shtetërisht ishin ngritur problemet e trashëgimisë shpirtërore dhe ato materiale të folklorit tonë tradicional. Për këtë arsye, dëgjimi i Grupit të Pilurit ishte me shumë interes për studiuesit, hulumtuesit, gjurmuesit, grumbulluesit e këtyre visareve. Personaliteti që asistoi dhe mbështeti kesi kuvendesh të artit popullor shqiptar, duke inkurajuar edhe vazhdimësinë për të ardhmen, ishte profesor Shuteriqi. Natyrisht nuk përjashtoj edhe të tjerë të këtyre fushave. Pas koncertit që u duartrokit dhe u pëlqye pa masë, në mënyrë të veçantë nga akademikë e artistë të mëdhenj, si profesor Shuteriqi, Dritero Agolli, Petro Marko e Çesk Zadeja, të gjithë na u drejtuan dhe ftuan për kafe në barin e Lidhjes. Komplet si grup u ulëm.

U dha porosia për qerasje dhe u futëm në bashkëbisedim. Profesor Shuteriqi më drejtohet me një propozim dëshire. Nëse mundemi të këndojmë këngën për Abdyl Frashërin? Kishte shumë dëshirë ta këndonim ashtu siç ishim të lirë, për kënaqësinë e haresë shpirtërore, ku do të bënin iso edhe të pranishmit. Këngëtares titullare i dhashë aprovimin: “Merrja Katina!” Ajo ia nisi këngën me zërin e saj epiko lirik: “Avdul prishe pasurinë/ një barë flori/ hiqe vaporit dhe vajte/ Brenda në Berlin/...”! Kënga vazhdoi e gjitha, deri sa u mbyll e tëra. Profesor Shuteriqi dhe Driteroi më të pranishmit e tjerë, jo vetëm që ishin dhe pjesëmarrës të isos, por e shoqëronin edhe me fjalën e belbëzuar nëpër buzë e nëpër grykë. Herë nëpër shpirt e herë nëpër dritën e shikimit të syve...! Ata imitonin ritmin e këngës me lëvizjet e supeve dhe dallgëzimin e gjokseve. Nuk ua shqitja sytë as Shuteriqit e as Driteroit.



Pas mbylljes së saj, një pauzë engjëlllore. Menjëherë nuk ia përtoi Shuteriqi dhe mu drejtua me atë elegancën e tij, stilist si një hark violine që luan sipër telave të temperuar tingujt e finesave. Me një delikatesë mjeshtërore hapi fletën e zemrës së vet dhe më tha: “I dashur Lefter, për këtë këngë tepër kombëtare jam shumë i interesuar. Ajo ka shumë vlera historike dhe më bën që të krenohem për këtë burrë kaq madhor në momentet më kritike dhe më delikate të politikës europiane të asaj kohe. Bën fjalë për atë kohë aq të turbulluar ballkanike ku kishin ndërmend që Shqipërinë ta shpërbënin krejt dhe si komb. Ka ndonjë gjurmim të kësaj kënge, që qëndron e freskët gati 100

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.